


Qëllimet e Përshtatshme Arsimore

Qëllimet e përshtatshme arsimore kanë rëndësi thelbësore gjatë zhvillimit të shkathtësive sportive dhe jetësore të pjesëmarrësve të rinj. Thënë thjesht, aktivitetet që zgjedhën nga trajneri si pjesë e një sesiioni të trajnimit për S4D nuk duhet të jenë as shumë të lehta e as shumë të vështira për pjesëmarrësit, dhe gjithmonë duhet t'i **përshtaten kontekstit personal dhe socio-kulturor, si dhe të kaluarës së pjesëmarrësve të rinj** në përpjekje për ta menaxhuar diversitetin. Si gjithmonë, duhet pasur parasysh se ekzistojnë pesë parime kryesore dhe se S4D mund ta zhvillojë potencialin e plotë vetëm nëse të gjitha parimet merren parasysh dhe zbatohen.

Ajo që mund të tingëllojë e thjeshtë në letër mund të jetë e vështirë në praktikë. Një trajner i mirë është në gjendje ta përgatis një sesion trajnimi në atë mënyrë që t'i inkurajojë dhe zhvillojë të gjithë pjesëmarrësit e rinj në mënyrë të barabartë, gjithmonë duke e pasur parasysh nivelin e shkathtësive të tyre individuale dhe nevojat e tyre personale. Për ta arritur këtë, është me rëndësi që t'i kemi parasysh disa faktorë kyç që i përcaktojnë nevojat e pjesëmarrësve të rinj.



E **kaluara personale** e pjesëmarrësve të rinj ndikon në nevojat e tyre në çdo fazë të jetës. Për shembull, një pjesëmarrës i ri me një temperament të dhunshëm mund të përfitojë nga aktivitetet me fokus të veçantë në parandalimin e dhunës. Nga anatjetër, fëmijët ushtarë të traumatizuar, mund të përfitojnë nga një set shkathtësish krejtësisht të ndryshme. Një trajner i mirë i S4D është i vetëdijshëm për këto rrethana personale dhe planifikon aktivitetet në përputhje me to. Trajneri, po ashtu, duhet të jetë i vetëdijshëm se pjesëmarrësit kanë qëllime të ndryshme personale, prandaj duhet t'i zhvillojë aktivitetet e S4D me synim që t'u ndihmojë pjesëmarrësve të rinj ta arrijnë potencialin e tyre të plotë personal.

E kaluara personale

Niveli i shkathtësive i referohet **katër dimensioneve të zhvillimit** nëpërmjet S4D (kognitive, shoqërore, sportive dhe fizike). Pjesëmarrësit e rinjdo të jenë në faza të ndryshme të zhvillimit për sa i përket këtyre dimensioneve, prandaj aktivitetet duhet të strukturohen në atë mënyrë që t'u mundësojnë të gjithë pjesëmarrësve ta arrijnë potencialin e tyre të plotë. Këtu mund të përfshihet përcaktimi i aktiviteteve të ndryshme për pjesëmarrësit me nivele të ndryshme të shkathtësive.

Niveli i shkathtësive

Mjedisi kulturor i një programi të S4D luan rol të rëndësishëm në formësimin e tij. Pavarësisht se bëhet fjalë për rolet dhe marrëdhëniet ndërmjet gjinive, kulturën e të mësuarit ose sa janë të rrepta ose fleksibile strukturat hierarkike, mjedisi kulturor gjithmonë duhet të merret parasysh kur zhvillohen aktivitete e S4D.

Mjedisi kulturor

Mosha e pjesëmarrësve të rinj është një nga faktorët më me ndikim që i udhëheqin nevojat e tyre. Udhëzimet që i përshkruajnë karakteristikat themelore dhe objektivat e pjesëmarrësve bazuar në gjendjen e tyre fizike dhe mentale në faza të ndryshme të jetës, mund të gjinden në ueb-faqen "Sport for Development Resource Toolkit" nën: [Tools For Your Practice – S4D Teaching and Learning Materials – South Africa – YDF Manual for Coaches, South Africa.](#)

Mosha

Përgjithësisht, pjesëmarrësit e rinj mund të ndahen në katër grup-mosha me objektiva të ndryshëm kryesorë të cilët duhet t'i dijë një trajner.

Mos harroni se **fëmijët e të njëjtës moshë mund të jenë nëfaza të ndryshme të zhvillimit**, mirëpo, për sa i përket shkathtësive sportive dhe jetësore, faktorët kyç, siç është e kaluara personale, ndikojnë gjithmonë edhe në nevojat e tyre.



Shembujt se si mund të duket një sesion trajnimi për S4D në sporte të ndryshme i përshtatur për një moshë të caktuar mund të gjenden në ueb-faqen 'Sport forDevelopmentResourceToolkit'ën: [Tools For Your Practice – S4D Teaching and Learning Materials – Namibia](#).

Trajneri duhet t'i përfillë disa udhëzime të caktuara që do t'i ndihmojnë t'i përcaktojnë qëllimet e përshtatshme arsimore, duke i marrë parasysh të gjitha informatat e cekura më herët. Për të zhvilluar seanca trajnimi në mënyrë të suksesshme, trajneri duhet t'i ketë parasysh çështjet si në vijim: (Këto **udhëzime nuk janë gjithëpërfshirëse** ose të plota, dhe duhet të plotësohen në përputhje me nevojat personale dhe rrethanat e pjesëmarrësve të rinj.)

- ✓ Cilat janë të arriturat në të kaluarën dhe historiku personal i pjesëmarrësve?
- ✓ Cili është niveli aktual i shkathtësive sportive dhe jetësore të pjesëmarrësve?
- ✓ Identifikoni shkathtësitë sportive dhe jetësore që do të trajtohen (për më shumë informata lidhur me këtë, shih kursin bazik mbi *Zhvillimin e Shkathtësive Jetësore*).
- ✓ Renditni qëllimet sipas prioriteteve të tyre.

Meqenëse pjesëmarrësit do të jenë në faza të ndryshme të zhvillimit për sa i përket aftësive të tyre kognitive, përqendrimit dhe qëndrueshmërisë etj., varësisht nga moshja e tyre, periudha kohore e një seance trajnimi duhet të përshtatet në përputhje me kërkesat dhe moshën e pjesëmarrësve. Përgjithësisht, trajnerët duhet të përpiqen që t'u përmbahen rekomandimeve të mëposhtme për sa i përket **kohëzgjatjes së një seance trajnimi për S4D**:

